

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	1338 kilometra me një karikim, piloti polak sfidon kufijtë e makinës elektrike dhe vendos rekord Guinness
ADRESA	https://kohajone.com/teknologji/1338-kilometra-me-nje-karikim-piloti-polak-sfidon-kufijt-e-e-makines-elektrike-dhe-vendos-rekord-guinness/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 20:07:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 20:02:23 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9429ae5bba16eaf63ecac15a66d2b261ffcc9c82522bad0b7c100b4a656d0d9e
TEKSTI	be2ded1294ff4e4408490e0f459664fc4d36bf34cac1522e22c5a0e44e44821c
PAMJA	724557a8da6663e747f7f944671f977494ce1f12befacad5b8ed3ab13ca16ce3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8e12fa76c9c84226990c48a95203573e140df0371ed52c671bbdb5ee38e508ba
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8e12fa76c9c84226990c48a95203573e140df0371ed52c671bbdb5ee38e508ba>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

1338 kilometra me një karikim, piloti polak sfidon kufijtë e makinës elektrike dhe vendos rekord Guinness

AKTUALITET TEKNOLOGJI E DIEL, 27 SHTATOR 2026 22:02



Kur një pilot rally-je heq dorë nga kërkimi i shpejtësisë dhe vendos të luftojë për çdo vat-orë energjie, rruga shndërrohet në një laborator të jashtëzakonshëm efikasiteti.

Kështu ndodhi me Miko Marczyk, kampionin evropian të rally-t, i cili ka vendosur një tjetër rekord Guinness, këtë herë në timonin e një makine elektrike të prodhimit në seri. Me një Audi A6 Sportback e-tron performance, piloti polak përshkoi plot 1.338 kilometra me një karikim të vetëm të baterisë, duke e çuar autonominë shumë përtej shifrës së homologuar të modelit.

Audi deklaroi për këtë version një autonomi deri në 777 kilometra sipas ciklit WLTP. Marczyk arriti të udhëtojë edhe 561 kilometra më shumë, ose rreth 72 për qind mbi autonominë maksimale të deklaruar.

Por shifra 1.338 kilometra nuk është e vetmja që e bën këtë rekord të jashtëzakonshëm. Ajo që e shpjegon më mirë është konsumi mesatar: vetëm 7,09 kWh për 100 kilometra gjatë gjithë përjekjes.

Nga gara me shpejtësinë te gara me efikasitetin

Në pistat e rally-t, Miko Marczyk është mësuar të luftojë për sekonda. Këtë herë sfida ishte krejt tjetër: të udhëtonte sa më larg duke konsumuar sa më pak energji.

Tentativa nisi më 11 shtator, në orën 01:55 të mëngjesit, në Poloni. Rruga e çoi përgjatë lumit Vistula, përmes Krakow-it, Sandomierz-it, Varshavës, Torunit dhe Grudziadz-it, deri në Hel, në brigjet e Detit Baltik.

Por udhëtimi nuk përfundoi atje. Marczyk u kthye pothuajse në të njëjtën rrugë dhe vazhdoi të ecë derisa bateria u shterua. Pas më shumë se 45 orësh në rrugë, makina u ndal mes Torunit dhe Ciechocinek, pasi kishte përshkuar gjithsej 1.338 kilometra.

I gjithë udhëtimi u zhvillua në rrugë publike dhe në trafik real, jo në një pistë të mbyllur apo në kushte laboratorike.

Marczyk u përball edhe me periudha të trafikut të rënduar dhe me oraret e pikut të qarkullimit.

Temperatura mesatare gjatë udhëtimit ishte rreth 15°C, ndërsa në orët e para të mëngjesit, në zonën e Grudziadz-it, temperatura zbriti deri në 7°C. Kjo e bën edhe më interesante përjekjen, pasi temperatura dhe kushtet atmosferike mund të ndikojnë ndjeshëm në konsumin dhe autonominë e një automjeti elektrik.

7,09 kWh për 100 kilometra – shifra që tregon gjithçka

Nëse autonomia prej 1.338 kilometrash është shifra që tërheq vëmendjen, 7,09 kWh/100 km është numri që tregon se si u arrit ajo.

Audi A6 Sportback e-tron performance ka një bateri me 94,9 kWh kapacitet neto, ndërsa kapaciteti bruto është 100 kWh. Automjeti zhvillon 367 kuaj fuqi dhe përshpejton nga 0 në 100 km/h për 5,4 sekonda.

Megjithatë, gjatë rekordit, objektivi nuk ishte performanca në kuptimin tradicional të automobilizmit. Nuk bëhej fjalë për rëndësinë maksimale por për kontrollin maksimal të energjisë.

LAJMET KRYESORE



Mesazh urgjent i kryeministrit Rama sapo mbërriti nga SHBA (fjala e plotë)



A do të shkojë ambasadori Wendt në Selinë Blu për të takuar Berishën?



Shqipëria fiton me dy gola ndaj Bjellorusisë



Mirë se vjen, Ambasador Wendt!



Presidenti Begav zbardh takimin me ambasadorin e ri të SHBA, Eric Wendt

TË PËRZGJEDHURA



PREMIER LEAGUE – Po sikur Manchester City-t t'i hiqen të gjitha titujt? Si do të ndryshoni...



Singapori paguan qytetarët për të lexuar: 15 minuta në ditë në këmbim të parave



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetfo...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude

MË TË LEXUARAT

përshpejtimin maksimal, por për konsumin maksimal të energjisë.

Marczyk përdori një kombinim teknikash të drejtimit ekonomik: shpejtësi të qëndrueshme, parashikim të situatave në rrugë, shmangie të përshpejtimeve dhe frenimeve të panevojshme, presion të saktë të gomave dhe përdorim të rikuperimit të energjisë gjatë ngadalësimit.

Në këtë mënyrë, një makinë që në kushte homologimi deklaron konsum të kombinuar rreth 13,6–15,8 kWh/100 km, në varësi të specifikimit, arriti gjatë kësaj tentative një mesatare prej vetëm 7,09 kWh/100 km.



Aerodinamika që punon për çdo kilometër

Një pjesë e rëndësishme e këtij rezultati i takon vetë konstruksionit të Audi A6 Sportback e-tron.

Modeli ka një koeficient rezistence aerodinamike (Cd) prej vetëm 0,21, që Audi e përshkruan si vlerën më të mirë aerodinamike të arritur ndonjëherë nga një model i saj. Sipas kompanisë, në shpejtësi më të larta rreth 40 për qind e konsumit në ciklin WLTP lidhet me rezistencën aerodinamike.

Pra, rekordi nuk është vetëm historia e një piloti që drejton me kujdes. Është bashkimi i aerodinamikës, sistemit të fuqisë, menaxhimit termik, rikuperimit të energjisë dhe teknikës së drejtimit.

Automjeti përdor gjithashtu arkitekturë elektrike 800 volt dhe sistem rikuperimi që mund të arrijë deri në 220 kW. Audi thotë se rreth 95 për qind e frenimeve në përdorimin e përditshëm mund të mbuloen nga rikuperimi i energjisë.

Një rekord i dytë Guinness për Marczyk

Ky nuk është rekordi i parë Guinness i Miko Marczyk.

Në vitin 2025, piloti polak kishte përshkuar 2.831 kilometra me një rezervuar karburanti në një Škoda Superb të gjeneratës së katërt, me një konsum mesatar prej vetëm 2,6 litrash për 100 kilometra.

Këtë herë, sfida ishte e një natyre tjetër: jo sa larg mund të shkojë një makinë me një rezervuar karburanti, por sa larg mund të shkojë një automjet elektrik me një karikim të vetëm.

Dhe kontrasti është domethënës. Nëse rekordi i mëparshëm ishte një demonstrim i ekstremitetit të efikasitetit të një motori me djegie të brendshme, ky i riu shfaq potencialin e një tjetër epoke të automobilizmit: asaj elektrike.

Kur teknologjia takohet me disiplinën e drejtimit

Vetë Marczyk e përmbodhi përvojën duke theksuar se edhe për të, një rezultat prej 1.338 kilometrash ishte një surprizë.

Ai vuri në dukje kombinimin mes baterisë 94,9 kWh, aerodinamikës dhe teknologjisë së automjetit.

Por një rekord i tillë duhet lexuar edhe me një masë të rëndësishme konteksti: 1.338 kilometra nuk përfaqësojnë autonominë tipike që një përdorues do të marrë në përdorim të përditshëm. Rezultati u arrit përmes një stili drejtimi të orientuar posaçërisht drejt konsumit minimal të energjisë, në kushte dhe me një objektiv të ndryshëm nga përdorimi normal.

Megjithatë, pikërisht kjo e bën eksperimentin interesant.

Një makinë e projektuar për të përshkuar qindra kilometra pa karikim u vendos përballë një sfide ekstreme dhe tregoi se sa hapësirë mund të ketë mes shifrës së homologimit dhe kufirit fizik të efikasitetit kur bashkohen teknologjia dhe mjeshhtëria e drejtimit.

Në fund, Marczyk nuk fitoi këtë herë duke e shtypur më fort pedalin e gazit.

Ai fitoi duke e shtypur më pak.

Dhe kjo është ndoshta paradoksi më interesant i rekordit: piloti që zakonisht matet me shpejtësinë, këtë herë u bë kampion i durimit, parashikimit dhe kursimit të energjisë.

1.338 kilometra, një bateri, më shumë se 45 orë dhe vetëm 7,09 kWh për 100 kilometra – një rekord që nuk tregon vetëm sa larg mund të shkojë një makinë elektrike, por edhe sa larg mund të çojë teknologjinë kur çdo vat-orë kthehet në kilometër.

Albert Vataj



MË SHUMË NGA AKTUALITETI




Shtohen masat ndaj emigracionit, ministrat e Brendshëm të BE-së dhe B...

Blero me amanet për djalën: Nëse një ditë atdheu të thërret, të jesh ...

“Jemi kthyer në republikë bananesh, e vetmja industri është krimi”- A...





Aleksandar Vučić jep dorëheqjen si president i Serbisë



Pas 23 vitesh – Madonna rikthehet në MTV VMA, nga puthja me Bri...



Tragjedi në Fier, 70-vjeçari humb jetën në banesën e përfshirë nga fl...

LAJMET E FUNDIT

Fjala e Ramës: drejtësia të hetojë deri në fund, shteti të mos humbasë përgjegjësinë

6 MINUTA MË PARË

Vučić dorëhiqet nga presidenca, por kërkon të mbetet në pushtet

16 MINUTA MË PARË

Paulo Coelho, filozofia e një shkrimtari që flet me shpirtin dhe kumton se dashuria është shëlbim dhe jeta një udhëti...

23 MINUTA MË PARË

Shtohen masat ndaj emigracionit, ministrat e Brendshëm të BE-së dhe Britanisë kërkojnë mekanizëm të ri për krizat dhe...

34 MINUTA MË PARË

Blero me amanet për djalën: Nëse një ditë atdheu të thërret, të jesh aty ku qëndrojnë burrat – në ballë të UÇK-së

35 MINUTA MË PARË

“Krimi ka kokë!” – Mesazhi i protestuesve në ditën e 120-të: Marshimi përfundon para Parlamentit me thirrje kundër Ramës

36 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONË

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frashëri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHYVLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

